

QEVERISJA E MIRË
QEVERISJE E HAPUR DHE
LLOGARIDHËNJE NË
POLITIKË DHE PUSHTET

Autore: Blerina Ramaj, Open Data Kosovo

Analizë mbi qeverisjen e hapur të Pushtetit Ekzekutiv në Kosovë dhe rajon

Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

Shtator 2019



Ky publikim është prodhuar nga asistenca e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit ACTION SEE – Llogaridhënja, Teknologjia dhe Hapja institucionale në rajonin e Evropës Juglindore.

Autore: Blerina Ramaj, Open Data Kosovo

**Analizë mbi qeverisjen e hapur të
Pushtetit Ekzekutiv në Kosovë dhe rajon**
Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

Prishtinë, Shtator 2019

Hyrje

Në bashkëpunim me partnerë nga rrjeti rajonal i OJQ-ve 'Action SEE' Open Data Kosovo ka përpiluar këtë punim në të cilin analizojmë nivelin e transparencës, hapjes, dhe llogaridhënies së pushtetit ekzekutiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Punimi vjen si rezultat i një kërkimi të gjithëpërfshirës, i bazuar në metodologjinë shkencore, i cili është kryer nga anëtarët e rrjetit Action SEE përgjatë disa muajve që po lëmë pas. Qëllimi i gjithmbarshëm i hulumtimit është të ofrojë një pasqyrë më të detajuar në këto fusha, dhe të jap kontribut edhe në zbatimin e reformës në punën e administratës publike, për të pasur efekt në forcimin parimeve të qeverisjes së mirë dhe tu ndihmojë institucioneve në punën e tyre që t'i zbatojnë këto në mënyrë sa më efektive.

Ky punim është i treti me radhë në të cilin e kemi analizuar nivelin e hapjes së institucioneve dhe kemi dhënë rekomandime për përmirësim. Pas hulumtimit të parë të kryer në vitin 2016, kemi filluar ta përmirësojmë dhe adaptojmë metodologjinë e hulumtimit dhe treguesit e saj, duke u bazuar në diturinë tonë rreth të gjeturave dhe rezultateve të monitorimit. Hulumtimi i këtij viti është kryer mbi bazën e treguesve që do të na japin një pamje të qartë e cila na tregon se sa autoritete ekzekutive po punojnë drejt përmirësimit të hapjes së tyre gjatë vitit të kaluar.

Politika e qeverisjes së hapur duhet të jetë politikë e të gjitha qeverive të rajonit, dhe duhet të formulohet dhe të hartohet sikur çdo politikë tjetër me rëndësi dhe nuk duhet të jetë rezultat i vendimit momental apo gjendjes aktuale të qeverisë. Secili shtet i rajonit ka specifikën e vet, kushtet e veta politike në të cilat zhvillohet qeverisja e hapur, por njeri mund të vë re zbrazëtinë e dukshme e cila kërkon të mbushet përmes një veprimi të përbashkët rajonal për përmirësim të situatës.

Punimi ynë i adresohet vendim-marrësve në institucione të pushtetit ekzekutiv në vendet e rajonit në të gjitha nivelet: qeveri, ministri, dhe organe dhe agjenci tjera të administratës shtetërore. Gjithashtu do të jetë e dobishme edhe për përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, e gjithashtu edhe për kolegët tanë nga sektori i OJQ-ve të cilat merren me këto çështje.

Me qëllim që të arrihet një dialog publik me nivel të lartë të cilësisë lidhur me këto çështje, do të organizohet një sërë ngjarjesh publike, në të cilat do të dëgjohen opinionet e të gjitha grupeve të të interesuarve dhe do të përpiqemi të gjejmë zgjidhje të përbashkëta të qëndrueshme në zhvillim të mëtejshëm të kësaj çështjeje.

Ne gjithashtu do të zbatojmë të gjitha parimet e transparencës së kërkimit dhe do të informohen institucionet mbi të gjitha detajet e zbatimit dhe konkluzionet nga ky kërkim.

Jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikrat dashamirëse dhe diskutimet lidhur me këtë punim.

Qeverisja e hapur në institucione të pushtetit ekzekutiv në rajon

Autoritetet ekzekutive në rajon kanë përbushur 48.41% të kriterëve për një qeverisje të hapur. Megjithëse rezultati i këtij kërkimi paraqet një rritje të lehtë në nivelin prej 5% të hapjes në qeverisje krahasuar me kërkimin paraprak, përkundër këtij përmirësimi të lehtë lë akoma për të dëshiruar. Një rritje në nivelin e hapjes shihet më së shpeshti si miratim nga autoritetet individuale në vendet e rajonit, dhe jo si rregull i sistemit të qeverisë. Kjo shihet kështu për arsye se ka mungesë të politikave të qarta që ruajnë vlerën e hapjes institucionale dhe, mbi të gjitha, dhe për mungesë të rregullave dhe sanksionimeve në raste kur apo nuk zbatohen.

Kërkimi edhe një herë ka ardhur në përfundim se institucionet pushtetit ekzekutiv janë më të hapura sa më shumë që i afrohemi niveleve më të larta të qeverisë. Megjithëse, qeveritë e vendeve të rajonit përbushin mesatarisht 63.62% të treguesve të qeverisjes së hapur, ministritë e linjave përbushin 50.58% dhe organet e administratës shtetërore përbushin 32.22%. Një mospërputhje është vënë re brenda vet institucioneve, gjë e cila dëshmon se çështja e qeverisjes së hapur në parim varet nga vullneti dhe përkushtimi i krerëve të atyre institucioneve, dhe nuk varet nga niveli i zhvillimit të praktikave apo rregulloreve të një vendi. Situata të tilla sjellin në pikëpyetje praktikat e mira të cilat janë të njohura individualisht nga institucionet në situata kur ndodhin ndryshime personale.

Pritet që prania e nismave ndërkombëtare, të tilla si Open Government Partnership, në vende të rajonit, do të kontribuojë në zhvillimin e hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Përkushtimi dhe angazhimi i vendeve të rajonit në këtë nismë ndryshon sa i përket shkallës së pjesëmarrjes, gjë që dëshmon gatishmërinë e qeverive për të zbatuar dhe promovuar standardet e qeverisjes së hapur dhe llogaridhënies.

Standarde si ato të paraqitura në këtë punim kërkimor gjithashtu meritojnë vëmendje nga ana e Bashkimit Evropian (BE), duke kujtuar se është e nevojshme të aplikohen paralelisht me vende tjera që aspirojnë rrugën e anëtarësimit në BE. Në raportet e fundit të progresit, janë vënë në pah një varg problemesh në fushën e transparencës, duke ia nisur nga zbatimi i tyre në kundërshtim me ligjin i qasjes të lirë në informata deri te transparenca e pamjaftueshme sa i përket buxhetit dhe sistemit të prokurimit.

Të gjitha vendet e rajonit duhet të përkushtohen në promovimin e qasjes së lirë proaktive në informata e cila është e garantuar me ligj, ngase askush nuk ka të drejtë të mbajë monopolin mbi informata publike të rëndësishme që u takojnë qytetarëve. Njashtu, nevojitet të planifikohen dhe të zhvillohen politika që do të duhej të kishin për bazë dokumente ligjore dhe strategjike të shtetit. Kjo përfundimisht përfaqësonte një kurorë të një procesi shumëvjeçar dhe përpjekjet të akterëve si vendor ashtu edhe të atyre ndërkombëtar në funksion të 'qeverisjes së hapur' në administratën shtetërore.

Me rastin e dhënies së kontributit në themelimin e një sistemi të tillë, më poshtë po ju sjellim një listë të mangësive që vendet e rajonit duhet t'i mënjanojnë për të siguruar qeverisje të hapur në punët e administratës publike.

Transparenca organizative dhe inanciare

Parimi i qasjes proaktive në informata nuk po zbatohet në nivel të kënaqshëm nëpër institucionet e pushtetit ekzekutiv në rajon. Qytetarët e rajonit vazhdojnë të hasin në vështirësi lidhur me atë se çfarë pune kryejnë institucione të caktuara dhe se çfarë planifikojnë dhe si do t'i shpenzojnë fondet nga buxheti. Problemet janë të pranishme në kuptim të mungesës së transparencës për sa i përket buxhetit, llogarive përfundimtare, si dhe procedurave të prokurimit.

Gjithashtu, rrallë del ndonjë institucion në nivel rajoni me publikim të raporteve të tyre periodike financiare.

Situata nuk është në nivel të kënaqshëm as kur flasim për publikimin e programeve dhe raporteve të punës, megjithëse këto janë dokumente bazë përmes së cilave institucionet do të duhet të iu ofronin qytetarëve ide se çfarë po planifikojnë të bëjnë dhe se çfarë kanë bërë vitin e kaluar. Praktika e përpilimit dhe publikimit të raportit gjashtë mujor të punës është vënë re se mungon në një numër shumë të vogël të institucioneve.

Transparenca në procesin vendim-marrës

Shumica e vendeve të rajonit nuk kanë siguruar transparencë në mbledhjet e qeverisë. Megjithëse transkriptimet do të duhej të publikoheshin bazuar në standardet e transparencës si dhe do të duhet të kishte një video transmetim të mbledhjeve, madje shumica e qeverive nuk bëjnë publike as procesverbalet dhe as materialet nga këto mbledhje. Kësisoj, qytetarët mund të informohen lidhur me punët në shumicën e administratave lokale vetëm përmes kumtesave për shtyp pasi përfundimit të mbledhjes. Kjo praktikë duhet të merr fund menjëherë, sepse ky mohim në qasje të informatave lidhur me politikat kyçe, të cilin e aplikon qeveria, zvogëlon mundësinë e qytetarëve që të mbajnë nën kontroll të zgjedhurit e tyre dhe t'i mbaj përgjegjës për aktivitetet e tyre. Një problem i veçantë është klasifikimi i pajustificueshëm i dokumenteve me shenjën e sekretit.

Qasshmëria dhe komunikimi me qytetarë

Shumica e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve ekzekutive janë të përditësuara rregullisht me lajme dhe aktualitete ditore. Sidoqoftë, vihet re boshllëk i konsiderueshëm ku nevojitet përmirësim në mënyrën e organizimit dhe përmbajtjes së administratës. Qeveritë e shumicës së vendeve kanë faqe zyrtare të vjetruara të internetit e që kanë nevojë të programohen që të jenë në hap me zhvillim modern informativ dhe me zgjidhje në komunikim.

Një shumicë dërrmuese e institucioneve janë shumë larg nga standardi i faqeve zyrtare të internetit i njohur si 'bëj tri klikime gjej informatën që do'. Publikimi i të dhënave në formatin open data ende nuk praktikohet në rajon.

Megjithëse shumica e qeverive të rajonit kanë krijuar sistemin elektronik e-qeveria, në praktike nuk ka gjetur zbatim në nivel të kënaqshëm. Dobia nga shërbimet e ofruara nga këto portale është e diskutueshme për shkak se shfrytëzimi i tyre është i pamjaftueshëm. Megjithëse qeveritë do të duhej të ndërmerrnin hapa të duhur drejt zbatimit të fushatave reklamuese të e-Qeverisë, shumica e faqeve zyrtare të internetit madje nuk kanë as banderola me të cilat do të udhëzohej qytetari se si do të duhej ta përdorte këtë portal. Si dhe, sistemi i eQeverisë në rajon nuk njofton për shërbime lokale që janë me rëndësi dhe që janë në funksion të përmirësimit të obligimeve ditore të qytetarëve. Gjatë punës me qytetarë, ende dominojnë rrugët konvencionale të komunikimit. Më pak se gjysma e autoriteteve ekzekutive kanë dhe përdorin rregullisht rrjetet sociale si mjete për informim dhe komunikim me qytetarë.

Plani ikimi i politikave dhe Koordinimi

Qeveritë në rajon ende kanë punë për të ndërtuar procedura dhe praktika përmirësimi në politikat e tyre për planifikim dhe koordinim, si dhe në ofrimin e mekanizmave përmes të cilëve qytetarët monitorojnë qartazi zbatimin e tyre. Qeveritë e rajonit në përgjithësi nuk kanë zhvilluar praktika të planifikimit të politikave publike në kuptim afatgjatë e as metoda programore të punës. Autoritetet ekzekutive nuk i kanë kushtuar vëmendje të mjaftueshme matjes së cilësisë dhe ndikimit të punës së tyre, apo janë të rralla institucionet që na kanë deklaruar se përdorin tregues të performancës me rastin e përgatitjes së programeve të tyre si dhe raporteve të punës.

Qeverisja e hapur e Pushtetit Ekzekutiv në Kosovë

Gjatë matjeve të kryera në vitin 2018, Qeverisja e hapur në Institucione të Pushtetit Ekzekutiv të Kosovës kanë shënuar shkallën 49% në përmbushje të një morie treguesish, pra jemi barabar me Shqipërinë, e që na bën të renditemi në vendin e dytë, ku në vendin e parë renditet Mali i Zi me një përqindje prej 58% të përmbushjes së treguesve. Këto rezultate dëshmojnë se Kosova ka shënuar avancim në krahasim me vitin e kaluar ku shkalla e përqindjes ishte 33% dhe renditej në vendin e tretë në nivel rajoni. Kosova ia ka dalë ta rendis veten në pozitë më të lartë në

çdo strukturë të hierarkisë së vet në Pushtetin Ekzekutiv, me ç' rast zyra kryesore ekzekutive, gjegjësisht Zyra e Kryeministrit ka kapur shifrën 53% të treguesve të përmbushur, agjencitë ekzekutive me 26% dhe ministritë e linjës kanë kapur shifrën në total prej 55%.

Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit

Zyra e Kryeministrit ka kapur në total shifrën prej 53% për vitin 2018. Edhe pse Kosova ka shënuar progres krahasuar me rezultatet e vitit të kaluar ku po kjo zyrë pra Zyra e Kryeministrit kishte kapur shifrën prej 41%, derisa akoma mbetet vend për përmirësim krahasuar me shtete të tjera të rajonit pasi ato kanë shënuar rezultate më të larta në krahasim me Kosovën. Duke shënuar rezultat të barabartë me Serbinë, që të dy shtetet janë renditur në vendin e parafundit sipas rezultatit rajonal për qeverisje të hapur, ashtu që mbrapa mbetet vetëm Bosnja dhe Hercegovina. Për më tepër, duke marrë parasysh se Zyra e Kryeministrit ka nevojë të paraqes shembull për institucione të tjera në këtë rast bëhet fjalë për ministritë e linjës, nuk duket se po ndiqet ky shembull. Rezultatet e indeksit ishin arritur duke marrë parasysh katër Parime të qeverisës së hapur, të cilat përfshijnë: qasshmëri, ndërgjegjësim, integritet dhe transparencë.

Qasshmëria

Kur vjen puna te parimi i qasshmërisë, Kosova vazhdon të ballafaqohet me shumë probleme. Në vitin 2018 Zyra e Kryeministrit kishte kapur shifrën 56%, gjë e cila fliste për rënie krahasuar me vitin paraprak që kishte kapur 60%. Kosova ende renditet si e parafundit në nivel rajonal, duke e lënë pas vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën. Përveç kësaj vlerësimet flasin për një infrastrukturë të mirë që lejon liri të informacionit, e drejtë kjo e cila garantohet me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, përkundër të gjitha këtyre ende hasim në mungesë të realizimit të tij në praktikë. Siç raportohet për një numër të kërkesave nga ministritë dhe institucionet tjera publike të cilat pranohen nga Zyra për qeverisje të mirë, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, një numër i këtyre kërkesave është hedhur poshtë apo nuk ka marrë përgjigje, dhe për këto institucionet nuk mund marrin përsipër përgjegjësinë. Sepse ligji e thotë qartë se në rast një kërkesë hedhet poshtë, atëherë kjo duhet të arsyetohet me anë të një aktgjykimi. Në anën tjetër institucioni ka caktuar një person në detyrë i cili do të merret

kërkesa të LSI dhe se ekziston një afat i caktuar kohor për të kthyer përgjigje në këto kërkesa. Madje edhe raportet vjetore të qasjes në dokumente publike janë bërë publik, nuk ka asnjë lloj kontrolli mbi atë se përse disa nga kërkesa janë refuzuar ose nuk është kthyer përgjigje në to gjë që është e kundërligjshme.

Një tjetër problem është se ende nuk po gjen aplikim e drejta e qasjes në informata në ndërmarrje shoqërore, kompani publike, dhe subjekte të tjera të cilat ose janë në pronësi ose kontrollohen nga qeveria. Institucionet të tilla si Zyra e Kryeministrit po dështojnë në ofrimin e listave apo regjistrave publik nga dokumentet në dispozicion të tyre dhe të njëjtat nuk po i bëjnë publike, përkundër faktit se një veprim i tillë parashihet edhe me ligj. Një hap sado simbolik në këtë drejtim, e që nuk është i vështirë për tu realizuar, do të rriste shifrën e përmbushjes së kriterëve me këtë do ta rendiste Kosovën në pozitë më të lartë në nivel rajonal por me sa duket nuk po shihet si e nevojshme të jetë pjesë e agjendës së këtyre institucioneve

Një tjetër rekomandim, i cili ka dalë nga matjet e realizuara vitin e kaluar, shkon për Zyrën e Kryeministrit, ku kërkohet që kjo e fundit të ndërmerr masa dhe të jetë më aktive në ndërveprim me qytetarë. Si hap i parë drejt përmirësimit të këtij aspekti në sferën e qeverisjes së hapur do të ishte ndërrimi i metodave dhe kalimi drejt atyre moderne të komunikimit, siç janë Twitter, dhe Facebook. Llogaritë në Twitter ose Facebook nuk janë të lidhura me llogarinë e Kryeministrit, mirëpo ato janë të lidhura me institucionet dhe me zyra të tjera që janë të lidhura me Zyrën e Kryeministrit.

Në lidhje me konsultimet publike, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Qeverisjes së Mirë kanë zhvilluar një platformë të Konsultimit Publik në të cilën të gjitha dokumentet që kanë nevojë për konsultim me publikun bëhen publike online nga ministritë ku preken çështje relevante. Përveç kësaj, gjithashtu publikohen edhe raporte që dalin pas konsultimit me publikun.

Ndërgjegjësimi

Kur flasim për ndërgjegjësimin, Kosova ka përjetuar një rritje prej 10% nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, ashtu që kap shifrën prej 37%. Sidoqoftë, ende qëndron në pozitën e parafundit, ku prapa saj mbetet vetëm Serbia, e cila ka shënuar 0% në këtë parim.

Megjithëse ekziston një zyrë funksionale për planifikim strategjik, një prej elementeve kyç që po mungon nga niveli i Zyrës së Kryeministrit po vazhdon të mbetet vlerësimi dhe monitorimi i gjithmbarshëm i projekteve dhe politikave. Dhe në të gjithë këta tregues Kosova ka shënuar rezultat 0%. Edhe pse janë Udhëzimet Administrative, në këtë aspekt Zyra e Kryeministrit ka dështuar në ofrimin e këtyre informatave. Një pasqyrë kontekstuale tregon se Kosova ka qenë e ekspozuar përballë shumë projekteve të drejtuara nga politikat e caktuara nga donatorët. Edhe përkundër se, nuk ekziston asnjë mekanizëm për monitorim të performancës të këtyre projekteve dhe politikave dhe ndikimi i planeve dhe programeve të reformave. Progresi apo regresi i cili nuk arrin të dokumentohet paraqet sfida të madhe për një qeverisje të hapur, e gjithashtu edhe rrezik për punë joefektive në të ardhmen.

Sidoqoftë, Kosova ka kapur shifrën prej 100% në fusha të ndara të raportimit në Ministri. Këtë shifër e ka kapur kryesisht duke iu falënderuar rregullave procedurale, të cilat specifikojnë llojin e informacionit i cili kërkohet nga raportet e ministrisë e cilat i dërgohen Zyrës së Kryeministrit për miratim.

Integriteti

Mbi parimin e integritetit, Kosova vazhdon të shënoj progres nga viti në vit. Në vitin 2018, Zyra e Kryeministrit ka kapur shifrën prej 85%, dhe kështu është renditur e treta në nivel rajoni. Edhe pse në anën tjetër me këtë kishte shënuar rënie nga renditja e vitit 2017, Kosovo prapë kishte shënuar rritje të përqindjes një vit më vonë. Kjo rritje kryesisht i atribuohet kodit të sjelljes për shërbyes civil në Republikën e Kosovës. Për më tepër, që të gjithë anëtarët e kabinetit janë të obliguar të deklarojnë pasurinë e tyre në deklaratat e pasurisë. Pasi që treguesit e integritetit janë të lidhur me deklarimin e pasurisë, kodin e sjelljes, dhe konfliktin e interesit, gjë që të gjitha janë rregulluar dhe shih për këtë e rendit këtë institucion në maje të renditjes.

Aq më pak, Kosova ende çalon në realizimin e rregulloreve mbi lobistët dhe aktivitetet e tyre, e cila do t'i ndihmonte në rrugën e vet drejt një mbrojtje edhe më të madhe të interesit të publikut. Ne gjithashtu i japim rekomandim qeverisë së Kosovës të filloj të organizoj trajnime për zyrtarët e saj për temat që lidhen me konfliktin e interesit, parandalimit të korrupsionit apo sinjalizimit dhe

procedurat se si të veprohet në rast se hasim në ndonjë parregullsi, marrë parasysh se Kosova ka aprovuar Ligjin për Sinjalizues.

Transparenca

Parimi i transparencës parasheh që informatat e një organizate, buxheti, dhe procedurat e prokurimeve publike të jenë publike dhe rregullisht të publikohen në faqe zyrtare. Vetëm rreth këtij parimi, Zyra e Kryeministrit ka kapur shifrën prej 41% dhe ishte renditur si e fundit në rajon.

Kur vjen puna te transparenca sa i përket një informate të një organizate në një faqe zyrtare, kjo e fundit zakonisht ka materiale të bollshme të kumtesave për shtyp nga mbledhjet e qeverisë, dokumente zyrtare, raporte, strategji, dhe plane vjetore të punës. Mbi atë që u tha më lart, nuk ka informacion lidhur me shërbyesit civil të cilët punojnë në atë institucion e as informata për kontaktimin e tyre gjë që paraqet problem thelbësor lidhur me transparencën e personelit. Sidoqoftë, ekziston një problem sa i përket konsistencës dhe organizimit të dokumenteve të tilla brenda faqes zyrtare. Shpesh mungon përkthimi i informatave në dy gjuhë zyrtare, që është kusht i paraparë të plotësohet dhe i garantuar me kushtetutë.

Vështirësia më e madhe krahasuar me të gjitha vitet paraprake mbetet transparenca buxhetore. Shihet si dështim mospublikimi i raporteve gjashtëmujore në lidhje me shpenzimet e buxhetit shtetëror dhe qeveritar e gjithashtu edhe të buxhetit të qytetarëve. Gjithashtu nuk ka ndonjë informacion mbi nivelin e borxhi publik dhe se si është grumbulluar, rreth shlyerjes së borxheve apo menaxhimit të borxhit. Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave ka publikuar një përmbledhje të borxhit gjithëpërfshirës i cili pasqyron shpenzimet totale të bëra nga institucionet e Kosovës. Sidoqoftë, faqja zyrtare e Zyrës së Kryeministrit nuk jep ndonjë shifër konkrete, e mos të flasim për qasjen në informacion, të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës lidhur me buxhetin e planifikuar dhe shpenzimet qeveritare.

Përveç kësaj, faqja zyrtare e Kryeministrit ka dështuar në publikimin e thirrjeve për oferta, vendimeve dhe kontratave të lidhura në procedura të prokurimit publik. Një rrugë efikase për përmirësim të dukshëm në rezultatin e transparencës do të ishte publikimi i rregulloreve, planeve për prokurim dhe shpallja e rezultateve në faqe zyrtare ashtu që qytetarët të mund të kenë qasje dhe në këtë mënyrë të parandalohet korrupsioni.

Ministritë

Ministritë e Republikës së Kosovës plotësojnë 55% të treguesve për qeverisje të hapur. Që kur Kosova është renditur si e parafundit në rajon, ka shënuar progres të madh duke kapur shifrën prej 27% gjë e cila e ka ngritur në vendin e dytë në rajon. Kjo është pasi ministritë më shumë i janë përgjigjur pyetësorit të dërguar atyre, si dhe ka pasur më shumë informacion në internet në dispozicion të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara. Në krahasim me vitin 2018 Mali i Zi vazhdon të mbetet i pari me 67% të përmbushjes së kritereve të parapara me tregues. Në Kosovë, Ministria me qeverisjen më të hapur për vitin 2018 ka qenë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka kapur shifrën prej 81%, e cila pasohet nga Ministria e Administratës Publike, e cila ka arritur shifrën prej 77%. Ministria, e cila ka shënuar rezultatin më të ulët për hapje, vazhdon të mbetet Ministria e Punëve të Jashtme, e cila kap shifrën prej 20% të një sërë treguesish.

Pjesë e mostrës së matjes ishin 11 ministri prej 21 sa janë në total: Ministria për Komunitete dhe Kthim; Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Financave; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Administratës Publike

Qasshmëria

Në parimin e qasshmërisë e cila ka të bëjë me Qasjen në Informata, ndërveprimi me qytetarë nëpër konsultime publike ministritë kanë shënuar një rritje prej 30%, duke arritur një rezultat prej 58% dhe duke u renditur në vendin e dytë në rajon pas Malit të Zi. Prin Ministria e Administratës Publike me 90% dhe pasohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka arritur 86%. Kurse, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka nivelin më të ulët në qasje i cili shënon 20%. Kjo tregon se ende lë shumë për të dëshiruar. Shumica e ministrive çalojnë në fusha si trajnim për personel me fokus në qasjen e informatave publike dhe në përpilimin e një udhëzimi lidhur me ngritjen e çështjeve të ndryshme dhe procedimin e, kërkesave dhe ankesave të ndryshme i cili publikohet në internet në

faqen zyrtare. Shtuar kësaj, informacioni për të cilin qasja e lirë është e si LSI e aprovuar nuk publikohet e as nuk publikohen udhëzuesi i LSI as raportet. Duke ia shtuar kësaj faktin se, ministritë ende po dështojnë në ofrimin e një liste të dokumenteve të saj në dispozicion e që qytetarët do të duhej ta shihnin në internet pa pasur nevojë të shkojnë në institucion dhe të kërkojnë qasje në të.

Ndërgjegjësimi

Ministritë e Republikës së Kosovës prijnë për sa i përket parimit të Ndërgjegjësimit në rajon duke kapur kështu shifrën prej 60%. Ministritë si Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë të gjitha kanë kapur shifrën në nivel 100%. Në anën tjetër, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Punëve të Brendshme kanë shënuar rezultat me 0% sepse asnjëra nuk kanë bërë përpjekje ta plotësojnë pyetësonin.

Shumica e ministrive ia kanë dalë të dërgojnë raportet në Qeveri brenda afatit kohor ligjor, të cilat lidhen me realizimin e punëve sipas programit vjetor nga viti paraprak. Ato gjithashtu dërgojnë raportet e fundit financiare tremujore dhe vjetor për vitin aktual brenda po të njëjtit afat. Gjysma prej tyre përdorin tregues të performancës me rasti e zhvillimit të planeve vjetore të punës dhe raporteve vjetore të punës. Arsyeja përse nuk ka kapur shifër më të madhe se sa 60%, është se ministrit nuk i kanë bashkangjitur këto informatat pyetësorëve mbi atë se cilët janë treguesit, deri në ç' masë kanë arritur në përmbushjen e tyre dhe a kanë aplikuar të njëjtin standard sikur edhe të gjitha ministritë të tjera.

Integriteti

Vetëm në integritet ministritë e Republikës së Kosovës kanë kapur shifrën 54%, me këtë janë renditur në vendin e dytë në rajon për sa i përket këtij parimi. Ministritë kanë bërë progres të dukshëm në 2018 në krahasim me vitet paraprake. Ministria e Administratës Publike ka kapur shifrën më të lartë pra maksimumin prej 100%.

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Admisnitimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka kapur shifrën 68%. Derisa, ministritë e tjera kanë kapur shifrën 37%. Një rol vendimtar në rritjen e rezultatit për të gjitha ministritë ka luajtur publikimi i deklaratave të pasurisë. Edhe pse, ka mungesë të theksuar të publikimeve të planit të integritetit apo ndonjë politike tjetër të brendshme anti-korrupsion, e cilat përmban masa për parandalim dhe eliminim të formave të ndryshme të korrupsionit dhe sjelle në kundërshtim me etikën brenda institucionit.

Për të korrur rezultate akoma më të mira, ne i kemi rekomanduar Ministrive të linjës në Republikën e Kosovës, të organizojnë trajnime për zyrtarë të tyre me tema që prekin konfliktin e interesit, parandalimin e korrupsionit ose sinjalizimin dhe si të veprojnë në raste se vërejmë ndonjë parregullsi. Kjo komponentë nuk e mat integritetin e personelit as atë individual dhe nuk do të duhej të interpretohej si e tillë, sepse vetëm analizon politikat të cilat janë krijuar dhe që shërbejnë për mbrojtjen e integritetit dhe të institucioneve.

Transparenca

Për transparencën, Ministritë e Kosovës vazhdojnë të shënojnë rezultate dukshëm më të ulta. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal prin sa i përket transparencës me rezultatin 79%. Ministria më pak transparente është Ministria e Punëve të Jashtme, e cila ka shënuar vetëm 20%. Në vitin 2018 Ministritë shënuan kolektivisht 52% dhe u renditën në vendin e parafundit, duke lënë pas vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën. Rezultati i ulët është për shkak të përpjekjeve të Ministrive për të publikuar raporte pune vjetore dhe tremujore/gjysmë vjetore. Për më tepër, asnjë informacion për emrat, pozitat e punës, kontaktet e nëpunësve civilë apo pagat e tyre nuk është në dispozicion në faqen e internetit. Një problem tjetër i rëndësishëm është mungesa e informacionit në lidhje me planet e prokurimit publik në faqen e internetit.

Po aq të qasshme janë thirrjet për oferta, vendimet, kontratat ose anekset e procedurave të prokurimit publik.

Ministritë gjithashtu lënë pas dore detyrimin për të vënë në dispozicion plane buxhetore dhe për shpenzimet buxhetore. Më tej, nuk ka asnjë raportim të bërë ose duke u bërë nga ana e tyre në lidhje me këto fusha.

Agjencitë ekzekutive

Agjencitë Ekzekutive përmbushin vetëm 26% të kërkesave të treguesve të qeverisjes së hapur, duke u renditur kështu në fund të listës duke e ndarë këtë vend me Bosnje-Hercegovinën dhe pra duke u renditur pas çdo vendi tjetër të rajonit.

Pjesë e mostrës për matjet kanë qenë edhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Këshilli Ndërmintorror i Ujit (ish -Task Forca për Ujin), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Në një vështrim të veçantë të dhënë Agjencive Ekzekutive, Agjencia e Statistikave është në një pozitë më të mirë në lidhje me nivelin e qeverisjes së hapur, pasi ajo arriti një rezultat prej 47% bazuar në tregues. Ndërkohë, Këshilli Ndërmintorror për Ujë arriti një rezultat prej 15% dhe për këtë arsye vazhdon të mbetet më pak i hapur për agjencitë ekzekutive.

Për Qasshmërinë, Agjencitë Ekzekutive të Kosovës shënuan 17%. Ky parim ka të bëjë me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informacion, përmirësimin e informacionit në dispozicion përmes një mekanizmi të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Megjithatë, nuk është publikuar asnjë informacion për të cilin është aprovuar qasje e lirë. Faqet zyrtare të këtyre organeve nuk janë të azhurnuara dhe në shumicën e rasteve, janë shumë të vështira për të kryer kërkime në to ose thjesht informacioni mungon aty. Për më tepër, asnjë kanal i drejtpërdrejtë i komunikimit në internet nuk është në dispozicion në faqen e internetit përmes të cilit qytetarët mund të ngrenë shqetësime, të bëjnë ankesa dhe të parashirojnë apeline.

Sa i përket Parimit të Ndërgjegjesimit, Agjencitë Ekzekutive performuan më mirë. Ato kanë arritur të kapin shifrën prej 50% të kriterëve. Shumica e agjencive dorëzuan raportet vjetore dhe raportin financiar brenda afatit ligjor bazuar në përgjegjësi nga pyetësi. Për më tepër, gjysma e tyre kanë aplikuar tregues të performancës me rastin e hartimit të planeve dhe raporteve vjetore të punës. Kjo mundëson që qytetarët të informohen në krahasim me parimet e tjera, ku Kosova çalon të bëjë ndonjë progresi.

Parimi i Integritetit, ku Agjencitë Kosovare shënuan rezultat prej 12%, përfshin një mekanizëm për parandalimin e korrupsionit, sjelljen sipas kodit të etikës dhe rregulloret e lobimit. Aktualisht, nuk ka plan të integritetose ndonjë politikë tjetër të brendshme antikorrupsion të publikuar, e cili do të përfshinte masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe sjelljes joetike brenda institucionit. Në anën tjetër, Agjencia e Statistikave ka zhvilluar trajnime që prekin tema të konfliktit të interesit, parandalimit të korrupsionit ose sinjalizimit dhe si të veprohet në rast i parregullsive.

Për transparencën, Agjencitë Ekzekutive shënuan rezultat prej 27%. Kjo për shkak të mungesës së konsistencës në postimin dhe azhurnimin e faqeve të internetit të njërës prej Agjencive. Nuk ka asnjë informacion në dispozicion për emrat, pozicionet e vendit të punës ose pagat e funksionarëve publik ose nëpunësve civil. As programi vjetor i punës dhe as strategjitë nuk publikohen në faqen e internetit. Për më tepër, asnjë prej agjencive ekzekutive nuk ka publikuar plane të buxhetit ose shpenzime buxhetore në faqet e tyre të internetit. Kjo përbën një rrezik serioz për mos transparencën buxhetore. Ekziston gjithashtu një problem thelbësor në lidhje me transparencën në prokurimin publik e që ka të bëjë me të gjitha agjencitë.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Qeverisja e hapur është kusht kryesor i demokracisë pasi lejon qytetarët të marrin informacion dhe njohuri në lidhje me pjesëmarrjen e barabartë në jetën politike, vendimmarrjen efektive dhe institucionet përgjegjëse për politikën që ata kryejnë. Një numër vendesh ndërmarrin veprime specifike drejt rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve. Indeksi rajonal i hapjes së institucioneve kyçe në pushtetin ekzekutiv është zhvilluar për të përcaktuar se në çfarë mase qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informacion të favorshëm dhe të kuptueshëm nga institucionet e tyre.

Indeksi rajonal i masave të hapjes ku shihet se deri në çfarë mase institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, bazuar në katër parimet e mëposhtme: Transparenca, Qasshmëria, Integriteti, dhe Ndërgjegjësimi.

Parimi i transparencës përfshin që informacioni organizativ, buxheti dhe procedura e prokurimit publik të jenë në dispozicion dhe të publikuara. Qasshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informacion, përmirësimin e qasshmërisë në informacion përmes një mekanizmi të debateve publike dhe forcimin e bashkëveprimit me qytetarët. Integriteti përfshin mekanizma për parandalimin e korrupsionit. Parimi i fundit, Ndërgjegjësimi, ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e politikave të cilat zbatohen nga institucionet.

Në respektim të standardeve ndërkombëtare, rekomandimeve dhe shembujve të praktikës së mirë, këto parime zhvillohen më tej përmes treguesve specifikë, sasiorë dhe cilësor, të cilët vlerësohen në bazë të: qasshmërisë së informacionit në faqe zyrtare të institucioneve, cilësinë e kornizës ligjore për pyetje specifike, burime të tjera të informimit publik dhe pyetësorë që u janë dërguar institucioneve. Mbledhja e të dhënave u pasua me procesin e verifikimit të të dhënave e cila rezultoi në gabimin standard prej +/- 3%. Matja është kryer në periudhën nga dhjetori 2018 deri në fund të shkurtit 2019. Një seri rekomandimesh dhe udhëzimesh të drejtuara drejt institucioneve u zhvillua në bazë të rezultateve të hulumtimit. Një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh, të drejtuara drejt institucioneve, u zhvilluan në bazë të rezultateve të këtij kërkimi.

Rreth ActionSEE

ACTION SEE (Accountability, Technology and Institutional Openness Network in the South East Europe region) është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku në promovimin e llogaridhënjes në regionin e Evropës Jug-Lindore, duke ngritur potencialin për aktivizëm qytetar, promovimin e të drejtave të njeriut dhe liritë në internet, dhe duke ndërtuar kapacitetet dhe interesimin brenda shoqërisë civile për të përdorur teknologjinë për promovimin e demokracisë.

Antarët themelor të organizatës janë Metamorphosis nga Maqedonia, Center for Democratic Transition nga Mali i Zi, Center for Research, Transparency and Accountability nga Serbia, dhe Why Not nga Bosnja dhe Herzegovina. ACTIONSEE punon me partnerët nga Shqipëria të organizatës MJAFT! dhe Open Data Kosovo nga Kosova.

Open Data Kosovo (ODK) beson se hapja e të dhënave publike është shumë e rëndësishme në ndërtimin e një qeverisjeje të mirë, transparente dhe llogaridhënëse. Prandaj, të dhënat e zotuar nga institucionet shtetërore duhet të jenë publike, lehtë të qasshme dhe të prezentohen në formate të hapura. Publikimi i të dhënave të institucioneve shtetërore përmban kushtin bazik që qytetarët, shoqëria civile, akademitë dhe palët tjera të interesuara t'i përdorin këto të dhëna për të ndikuar pozitivisht në shoqëri.

OPEN DATA KOSOVO

Adresa: Rruga "Ganimete Terbeshi" 26A,
10000 Prishtina, Kosove

Email: info@opendatakosovo.org

Website: www.opendatakosovo.org



This project is funded by
the European Union

METAMORPHOSIS 



CRTA

CENTER FOR RESEARCH
TRANSPARENCY AND
ACCOUNTABILITY

ZaštoNe? 



The "Accountability, Technology and Institutional Openness Network in South East Europe - ACTION SEE" project is implemented by Metamorphosis Foundation, Westminster Foundation for Democracy, CRTA – Center for Research, Transparency and Accountability, Citizens Association Why not?, Center for Democratic Transition, Open Data Kosovo (ODK) and Levizja Mjajt!.